



GAZETA

Këshilli për etikë në media
në Maqedoni

Viti 2016

numri 2

Përmbajtje

- Emisione debative në TV 24 Lajme 2
- Publikime të shpallura për vetëregullim 2
- Konferencë regjionale "Sfidat e këshillave për etikë në media në regjionin e Balkanit" 3
- Takime me menaxhmentin e mediave 3
- Shënimi i Ditës të lirisë së mediave në Finland 4
- Ngjarje vjetore e Aliansës të këshillave të pavarur për etikë në Evropë (AIPCE) 4
- Hulumtim të perceptimeve për KEMM dhe vetëregullimit 5
- Trajnim për këshillat për etikë nga Evropa juglindore dhe Turqisë 5

NUMËR I RRIATUR I ANKESAVE DHE REAKCIONEVE TË PUBLIKUT PËR RAPORTIM MEDIAL JOPROFESIONAL

Gjatë vitit 2016, qytetarët deri te KEMM kanë dërguar gjithsej 85 ankesa, të cilat në numër më të madh janë për publikim të informatave jo të sakta dhe informata pa opinion të "palës së dytë", gjithashtu ankesat janë edhe për mosbërrjes të dallimit të qartë përmes informatave dhe komenteve, raportim jo të balancuar, gjuha e urrejtjes etj.



PREZENTIMI I KEMM DHE VETËREGULLIMIT PARA NJË PUBLIKU MË TË GJËRË

"Mediat, zgjedhjet dhe roli i vetëregullimit". Ishte tema e debateve regjionale, të cilat KEMM i organizoi në Prilep, Gostivar, Kavadar dhe Gjevgjeli. Në debatet u diskutua për domethënien dhe perspektivat e vetëregullimit, përvojat e deritanishme

të Këshillit për etikë si dhe bashkëpunimi me organizata të ngjajshme në korniza ndërkom-bëtare. Përveç kësaj, pjesëmarrësit u njoftuan me mënyrat se si KEMM merr masa në rastet konkrete të gazetarisë joprofesionale dhe jo-etike.

STUDENTET U NJOFTUAN ME KONCEPTIN E VETËREGULLIMIT MEDIAL



Anëtarët e Komisionit për ankesa, të bordit drejtues, dhe të zyrës ekzekutive të KEMM, i vizituan studentët e Universitetit të Evropës Juglindore në Shkup, Universitetit Goce Delçev në Shtip si dhe Universitetit Balkanik Ndërkombëtar në Shkup.

Në takimet, ata biseduan për konceptin e vetëregullimit, përvojat e deritanishme të Këshillit si dhe bashkëpunimi me organizata të njehta në korniza ndërkombëtare. U prezentuan rastet më interesante të cilat deri tani ishin të përpunuara nga Komisioni për ankesa, si dhe për efektin e mediacionit e cila është njëra nga veglat kryesore të KEMM për zgjidhjen e ankesave për gazetari joprofesionale dhe joetike.

Emisione debatuese në TV24 LAJME

Në periudhën prej qershorit deri në shtator të vitit 2016, KEMM ka pregaditur dhe realizuar katër emisione debatuese me titull "Etika në mediat, etika në shoqëri".

Në debatet është diskutuar për nevojën e vetëregullimit në mediat, funksionimi i KEMM si dhe sfidat me të cilat ballafaqohet, nevoja për profesionalizëm në punën e mediave, si dhe nevojën për reforma tek mediat. Në debatet morrën pjesë ekspertë për media, përfaqësues të trupit akademik, si dhe përfaqësues të sektorit civil.

Emisionet debatuese u realizuan me përkrahje të UNESCO-s, pranë proektit "Ndërtimi i besimit tek mediat në Evropën Juglindore dhe Turqia".

Publikime të shpallura për vetëregullim



Publikimi i OSbE-së "Udhëzues për vetëregullim në media - të gjitha pyetjet dhe përgjigjet" është përkthyer në gjuhën maqedonase, me ndihmë të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shkup si dhe me përkrahjen e programit të Civika mobilitas të Agjencionit Zvicërian për zhvillim dhe bashkëpunim.

Si shtojcë të udhëzuesit, KEMM ka pregaditur dhe ka shpallur publikimin "Vetëregullimi dhe gazetaria maqedonase".

Në korniza të projektit "Vëzhgim të demokracisë 2015: pluralizmi politik në media para dhe gjatë zgjedhjeve", KEMM ka pregaditur dhe ka publikuar "Doracak për fillet themelore dhe profesionale të profesionit gazetaresk", autor i të cilit është doktor Dejan Donev.


KARTA E KEMM PËR RAPORTIM ETIK GJATË ZGJEDHJEVE



Tredhjetë media të internetit, elektronike, dhe të shtypura nënshkruajtën kartën për raportim etik për zgjedhjet. Kartën e ka pregaditur Këshilli për etikë në media në Maqedoni në bazë të principeve univerzale dhe ato më kryesore të profesionit, të cilat gjinden në dokumente dhe publikime të federacionit ndërkombëtar të gazetarëve, nismës për gazetari etike, Fondacionit Rojters, Raportues pa kufi, Neni 19, etj.

Karta bazohet në principet e së vërtetës, dhe paanshmërisë, balancit, dallim të qartë mes informative dhe opinionëve, ndershmërisë dhe pavarësisë, solidaritetit profesional, pavarësi redaktuese, dhe integritet profesional, respekt dhe tolerance, liri dhe përgjegjësi.

"Ajo që është më me rëndësi reth Kartës janë principet e së cilës duhet në vazhdimësi të aplikohen në praksën e ditëpërditshme të raportimit medial. Rezistenca e mediave që të veprojnë në atë mënyrë nuk do të jetë rezistencë ndaj Kartës dhe inicijativës tonë por do të jetë rezistencë ndaj interesave të tyre dhe ndaj interesave të së mirës të gazetarisë, a me atë edhe humbja e statusit të një gazetari të mire."



Sot, shumë më shumë se më para, egziston nevoja gazetaria të jetë rëfyese e të vërtetës, gjetës i esences dhe shpjguesi i rethanave", theksoi Marina Tuneva, drejtore e KEMM.

"Shpresoj që nënshkrimet e juaj nuk do të jenë një shkronjë e vdekur në letër edhe se fillet etike do të mbesundojnë dhe nuk do të rënohen", porositi Mirçe Adamçevski, kryetar i Komisionit për ankesa pranë KEMM.

Ceremonia e nënshkrimit të kartës u mbajt me 12 shkurt, në EU Info qendrën në Shkup.

KONFERENCË REGJIONALE "SFIDAT E KËSHILLAVE PËR ETIKË NË MEDIA NË REGJIONIN E BALKANIT"

Përfaqësuesit e trupave vetëregullues nga, Maqedonia, Shqipëria, Bosna dhe Hercegovina, Bullgaria, Kosova, Srbija dhe Mali Zi, në Shkup diskutuan për gjendjen e vetëregullimit, për të trajtuar gjuhën e urrejtjes në media, për sfidat e etikës në botën digjitale, për diskriminimin përmes mediave dhe roli i këshillave të etikës.

Konferenca regjionale dy ditore "Sfidat e këshillave për etikë në media në regjionin e Ballkanit", KEMM e organizoi sëbashku me misionin e OSBE-së në Shkup dhe Ambasadën e Mbretërisë të Holandës.

Përmes tjerave pjesëmarrësit në konferencën provuan t'i përgjigjen pyetjes, a u përdoren të gjitha kapacitetet në internet për të siguruar përgjegjësi mediale. Gjithashtu, diskutuan për aktivitete dhe fushata për kyqje të aktorëve të ndryshëm në punën e këshillave për etikë, për ideat dhe sfidat, në pikëpamje të përgjegjësisë dhe transparencës të tyre, si dhe për mënyrat inovative për kyqje të qytetarëve në punën e këshillave.



Në diskutimet sipas temave pjesëmarrësit dhanë kontributin dhe pikëpamjet e tyre, duke nisur nga përvojat në shtetet e tyre. Ata, gjithashtu, rranë në përfundim se është e domësdoshme edhe më tutje të vazhdohet me këmbime të përvojave, me qëllim që të u jepet përgjigje sfidave dhe problemeve me të cilat ballafaqohen trupat vetëregullues.

Në ngjarjen u promovua doracak "Doracak për standardet themelore profesionale në profesionin gazetaresk", e pregaditur nga profesori Dejan Donev. "Idea për këtë doracak ishte të krijojmë diçka që do të jetë e shkurtër, gjegjësisht të paraqet një shoqërues të shkurtër në punën mediale, dhe mu për këtë, u përcaktuam ti paraqesim vetëm katër fillet morale, bazike dhe themelore të punës mediale, dhe prapë se prapë në masë të mjaftueshme ajo të jetë praktike dhe e paraqitur në mënyrë precize. Ky doracak të jetë përbërsi përmes fundusit teorik dhe shembujve praktike të profesionit, por edhe të asaj të bukurës, jo aq shumë në kuptim estetik por në atë etik", theksoi Donev.

TAKIM ME MENAXHMENTET E MEDIAVE



Njëzet redaktor, pronarë të mediave dhe drejtore të redakcioneve informative, në takimin e përbashkët, diskutuan për zhvillimin e ardhshëm të Këshillit për etikë, për nevojën për përkrahje të vetëregullimit në media si dhe për zgjidhjen e sfidave me të cilat ballafaqohet ky trup vetëregullues. "Kjo është mundësi për të diskutuar për përvojat e deritanishme të Këshillit për etikë në mediat me menaxhmentin e mediave, por edhe të njoftohemi me përvojat e këshillave të tjerë", theksoi në fillim të takimit punues, Marina Tuneva, drejtore ekzekutive e KEMM.

Përvojën e Këshillit për etikë në Norvegji e prezantoi Shell Nuhus, i cili theksoi se Këshilli mban primatin e "Zëdhënës-it" për lirinë e të shprehurit në këtë shtet. Këshilli Norvegjez për etikë është organizatë-ombrellë e të gjitha organizatave të mediave në vend, a fokusi kryesor i organizatës është ndërmarje të masave gjatë detektimit të rasteve ku cenohet liria e të shprehurit. Profesori Enes Osmançeviq, duke folur për rëndësinë e vetëregullimit në Bosnjë dhe Hercegovinë, potencoi se qëllimi kryesor i këtij trupi për vetëregullim, i cili ekziston më shumë se 16 vite, është për të mbrojtur mediat prej ndikimit të politikës dhe të mbrohet publiku nga



joprofesionalizmi. Njëra nga problemet më të shpesht të vërejtur është keqëpërdorimi i internetit, më së shpeshti për të ashtu quajturat betejet ideologjike. Në pjesën më të madhe të punës së tyre, ata ballafaqohen edhe me zgjidhje të kontesteve ku si qështje për shqyrtim paraqitet gjuha e urrejtjes. "Gjuha e urrejtjes në BH kalon prej urrejtjes mbi bazë etnike dhe fetare në atë drejt urrejtjes ndaj atyre me qëndrim të ndryshëm politik dhe ndaj LGBT komunitetit", tha Profesori Osmançeviq.

Mirçe Adamçevski, kryetari i Komisionit për ankesa, e theksoi nevojën për ndryshime në Kodeksin e gazetarëve, në pajtim me lëvizjet dhe ngjarjet aktuale dhe bëri thirrje për përkrahje nga mediumet në publikimet e vendimeve të Komisionit.

Për mënyrën e funksionimit të vetëregullimit në vetë redakcionet foli Aleksandar Damovski, redaktori kryesor dhe përgjegjës në portalin Mkd.mk. Ai theksoi që portalet shpeshere janë të keqëpërdorura nga politikanët. "Në gjithë procesin e ndarjes të mediave, ata jo rallë janë të lënë të vetëm", tha Damovski.

SHËNIMI I DITËS TË LIRISË TË MEDIAVE NË FINLAND



Prej 3 deri 5 maj të vitit 2016, përfaqësues të KEMM-it morrën pjesë në konferencën e OSBE-së, në rast me ditën Botërore të lirisë së mediave, në Helsinki të Finlandës. Gjatë konferencës ishte e prezentuar puna e KEMM-it dhe të Komisionit për Ankesa, a përmes tjerave është diskutuar edhe për mënyrat e shqyrtimeve të rasteve ku paraqitet gjuha e urrejtjes te mediat, e drejta për t'u informuar si e drejtë themelore, informuesit edhe mbrotja e burimeve të informatave.



NGJARJE VJETORE E ALIANCËS E KËSHILLAVE TË ETIKËS TË PAVARUR NË EV- ROPË (AIPCE)



Përfaqësues të KEMM morrën pjesë në konferencën vjetore të këshillave për etikë të pavarur në Evropë (AIPCE), e cila u mbajt me 5 dhe 7 tetor të vitit 2016, në Stokholm të Suedisë. Në këtë ngjarje janë ndarë përvoja nga puna e këshillave për etikë të Evropës dhe më gjërë, a është diskutuar edhe për sfidat me të cilat ballafaqohen trupat për vetëregullim në media. Këshilli Suedez për etikë këtë vit shenon 100 vjetorin e ekzistimit të vet.



Këshilli për etikë në media në Maqedoni ka shpallur raportin nga hulumtimi për rolin e KEMM-it në përf forcimin e profesionalizmit të mediat dhe afirmimin e vetëregullimit. Në hulumtimin morrën pjesë gazetarë dhe përfaqësues të organizatave civile nga gjithë shteti.

Rezultatet të cilat u prezentuan në qershor, tregojnë se 71% nga të anketuarit kanë njohuri për ekzistimin e KEMM dhe për mënyrat se si parashtrahet një ankesë deri te KEMM.

Nga ana tjetër, edhe pse të anketuarit, parimisht janë të vetëdijshëm për ekzistimin e këtij trupi, prapë se prapë janë të nevojshme përpjekje për përf forcimin e vetëdijes në drejtim të vetëregullimit medial si hap kryesor drejt përf forcimit të cilësisë të gazetarisë në shtet.

Në raportin analizohet edhe roli i Këshillit drejt internet-mediave, ashtu që numri më i madh i të anketuarve mendojnë se normat etike duhet në mënyrë të barabartë të zbatohen si për onlajn, ashtu edhe për mediat tradicionale.

Hulumtimi është realizuar me ndihmë të projektit " Përf forcimi i besimit tek mediat në Evropën Juglindore dhe Turqi", i finansuar nga OSBE-ja, dhe BE-ja.

TRAJNIM PËR KËSHILLAT PËR ETIKË NGA EVROPA JUGLINDORE DHE TURQIA



Në Konjic të Bosnjës dhe Hercegovinës, në 9 dhe 10 qershor të vitit 2016, është mbajtur trajnim për këshillat për etikë të Evropës Juglindore dhe Turqisë. Tre përfaqësues të Komisionit për ankesa dhe Bordit drejtues të KEMM-it, morrën pjesë në ngjarjen, të cilën e ka organizuar Këshilli për etikë nga Bosnja dhe Hercegovina.

Aktiviteti ishte pjesë e projektit " Përf forcimi i besimit tek mediat në Evropën Juglindore dhe Turqi", i përkrahur nga BE-ja dhe OSBE-ja. Gjatë dy ditëve është diskutuar për përvojat juridike, etike dhe sfidat në gazetarinë, si dhe për raportimin për interesin e publikut në epokën digjitale.

